

MUJË BUCPAPAJ

RRJETI I SISTEMIT TË METAFORAVE EMËRORE SHPREHJE E NJË PRIRJEJE INDIVIDUALE TË RRESHPJES

Folja si thurimë e vargut të gjatë të metaforave emërore në poezinë e Frederik Rreshpjes

- *“Kjo analizë strukturaliste e bazuar edhe në karakteristikat gjuhësore synon të tregojë një aspekt të pastudiuar të Rreshpjes si një poet modern, si njëri nga krijuesit që shquhet pikërisht për kujdesin ndaj gjetjes së strukturave komplekse të grupeve të veçanta gjuhësore, prej të cilave rrjedhin edhe nëntekste e mbartje të rëndësishme semantike dhe ideoartistike.”*

- *“Hipoteza e kësaj teme është se në vjershërinë e F. Rreshpjes, ndoshta më dukshëm se te çdo poet tjetër bashkëkohës i tij, folja na shfaqet si “thurimë” e vargut të gjatë të metaforave emërore, duke përbërë një tipar të veçantë të stilit poetik të Frederik Rreshpjes, dukuri që shfaqet aq dukshëm e me vlera të shënueshme estetike tek vëllimi i tij i parë me poezi: “Rapsodi shqiptare.”¹*

Studimi: “Folja si thurimë e vargut të gjatë të metaforave emërore në poezinë e Frederik Rreshpjes”, është një përpjekje për të shqyrtuar një veçori mjaft specifike të poezisë së Rreshpjes, e cila shfaqet mjaft qartë si në strukturimin e poezisë, duke u bazuar në një strukturë të ngjeshur metaforash emërore, zakonisht të rrethuara, apo të brendafutura mes foljesh, të cilat, kur e lexon dhe e kundron vargun edhe me sy në vjershërinë e shkruar, të duket si një thurimë mbrojtëse dhe kufizuese e metaforikës përkatëse.

Kjo analizë strukturaliste e bazuar edhe në karakteristikat gjuhësore synon të tregojë një aspekt të pastudiuar të Rreshpjes si një poet modern, si njëri nga krijuesit që shquhet pikërisht për kujdesin ndaj gjetjes së strukturave komplekse të grupeve të veçanta

¹ F. Rreshpja, *Rapsodi shqiptare*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968.

gjuhësore, prej të cilave rrjedhin edhe nëntekste e mbartje të rëndësishme semantike dhe ideoartistike.

Hipoteza e kësaj teme është se në vjershërinë e F. Rreshpjes, ndoshta më dukshëm se te çdo poet tjetër bashkëkohës i tij, folja na shfaqet si “thurimë” e vargut të gjatë të metaforave emërore, duke përbërë një tipar të veçantë të stilit poetik të Frederik Rreshpjes, dukuri që shfaqet aq dukshëm e me vlera të shënueshme estetike tek vëllimi i tij i parë me poezi: “Rapsodi shqiptare”².

Kjo veçori ndeshet në një varg poezish të vëllimit, si “De Rada”, “Shqipni”, “Alpet”, “Lokja”, “Elegji kosovare” etj., por kundrimi ynë është përqendruar në shqyrtimin e poezisë “Ajkuna”³, si krijimi që mendoj se do të mund të ndihmojë për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë karakteristikat e veçanta letrare të njërit prej poetëve më të mirë të poezisë shqipe, bazuar në analizën e tekstit, parë në varësi të karakteristikave të tij gjuhësore.

Vëllimi i parë me poezi i Rreshpjes: “Rapsodi shqiptare” shënon një zhvillim domethënës për poezinë shqipe, por njëkohësisht edhe një shënjim kërcënues për të ardhmen e tij, jashtë letrare. Lidhur me këtë, pa dyshim, është rasti të kujtojmë një vlerësim të shkrimtarit Ismail Kadare, i cili, si rrallëherë në shqiptimet e tij për kolegët poetë, pohon se “Frederiku ishte në atë kohë poet i njohur jo pak, një yll në ngjitje, siç thuhej, por pikërisht si i tillë, ngaqë shquhej për shkujdesje, e sidomos për talent të veçantë ngjante veçanërisht i rrezikuar.”⁴

Fragmenti vëzhgon çdo funksion, strukturor, stilistik për të arritur tek kuptimet më të qarta të një teksti të veçantë letrar, siç është poezia e F. Rreshpjes.

Për temën në tërësi, po edhe për sa përthekohet në referimin e sotëm, janë shfrytëzuar të gjitha shkrimet më serioze kritike dhe studimore të autorëve shqiptarë për F. Rreshpjen, materialet e

² F. Rreshpja, *Rapsodi shqiptare*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968.

³ Ajkuna është gruaja e Mujit, kryeheroit të “Ciklit të kreshnikëve”. Ajkuna qan Omerin” është një ndër lirikat më të bukura të epikës tonë legjendare.

⁴ I. Kadare, *Mëngjeset në Kafë Rostand*, Onufri 2014, f. 91.

Rrjeti i sistemit të metaforave emërore shprehje e një prirjeje individuale...

Arkivit të Shtetit, të Bibliotekës Kombëtare, shtypi i kohës, si dhe literatura ndërkombëtare e kësaj fushe specifike të studimeve, strukturaliste, letrare, përfshirë teoricienët e njohur të neoformalizmit, apo “Kritikës së re”, Cleanth Brooks⁵ dhe Robert Penn Warren⁶.

Kemi pasur parasysh edhe trajtimet e njohura kushtuar mjeshtërisë së të shkruarit, qoftë me karakter të përgjithshëm, sikundër janë “Leksionet amerikane” të Italo Kalvinos, si dhe traktatet teorike rreth ideimit dhe hartimit të studimeve shkencore nga Umberto Eko etj. si dhe botimet më të reja nga autorë shqiptarë. Nga hulumtimet e kohëve të fundit, me interes na është dukur libri “Fjala dhe ontologjia në poezinë bashkëkohore”, punim doktore i Baviola Shatros, në të cilën bëhet një analizë e realitetit poetik të Martin Camajt, Azem Shkrelit, Ali Podrimes dhe Agron Tufës, gati të gjithë bashkëkohës, shumica edhe bashkëmoshatarë të Frederik Reshpjes (me përjashtim të Agron Tufës), gjë që, natyrisht, edhe më tej gjatë studimit tim të doktoraturës, do të kem mundësi të vazhdojmë edhe me ndonjë përqasje e krahasim lidhur me strukturën e metaforikës dhe përgjithësisht të stilit letrar e procedurave

⁵ Cleanth Brooks (1906 -1994), profesor i shquar dhe një nga kritikët më me influencë në letërsinë amerikane. Brooks ishte figura qendrore e “Kritikës së Re” (New Criticism), një lëvizje e kritikës formaliste në mesin e shekullit të 20-të në SHBA. Veprat e tij më të njohura janë: The Well Wrought Urn: Studies in the Structure of Poetry (1947) and Modern Poetry and the Tradition (1939), të cilat ndihmuan për formulimin e parimeve të kësaj lëvizjeje.

⁶ Robert Penn Warren (1905 - 1989) ishte një poet, prozator dhe kritik letrar amerikan, i njohur si një nga bashkëthemeluesit e Kritikës së Re (New Criticism). Formalizmi është një shkollë e kritikës letrare dhe teori letrare që bazohet kryesisht në analizën strukturore të një teksti të caktuar, pa marrë parasysh ndonjë ndikim nga jashtë. Brooks është i vetmi krijues që ka fituar Cimet Pulitzer (Pulitzer Priz) njëkohësisht në prozë dhe në poezi. Warren ishte bashkautor me Cleanth Brooks, i librit me shumë influencë “Understanding Poetry”. Libri i tij me ese “New and Selected Essays” (Hardcover – 1989) përmbledh 13 ese te famshme për letërsinë, që përfshijnë botime të tij midis viteve 1942-1973.

ligjërimore e mirëfilli të togfjalëshave dhe grupimeve e përfitimeve pragmatistike të vjershërisë së Frederik Rreshpjes.

Argument

Rreshpja është një poet lirik që priret të bazohet në një strukturë stilistikisht interesante, gjë që shënon mendoj unë një aspekt konceptual të poetit. Intensiteti i brendshëm dhe shtysat (impulse) e vargut të metaforave emërore që vijnë si një zgjedhje tekstore, të ngjashme me një peizazh alpin, sjellin një profil kompleks të këngëve të vjetra epike shqiptare, siç është kënga “Ajku qan Omerin”, apo “Vaji i Ajkunës” e cila shoqërohet me nëntekste të forta dhe shumëkuptimësi. Kjo cilësi e poezisë dhe veçanërisht e metaforikës së Rreshpjes, nuk mund të mos vihej re edhe nga kritika letrare. “Poezia e Frederik Rreshpjes është me një kod dhe një apel simbolesh dhe nënkuptimesh. Në poezinë e tij është një finesë tepër e hollë, një delikatesë e brendshme që të habit. Të duket si trilli i metaforës deradiane hedh argjendin e vet të kaltër tek peizazhet e ashpra alpine, onirike, në agloshet e shpellave, ku mbijetojnë perënditë ilire, tek kasollja e vjeshtës me zogj mitesh...”⁷.

Kjo zgjedhje stili e cila është sa e vetvetishme, aq edhe e përshtatur, na jep bindjen se nuk është një dukuri e kërkuar nga autori, aq më pak të jetë e sforcuar në realizim, prandaj shohim dhe nuk mund të mos e theksojmë faktin që kjo e bën aq origjinal dhe specifik procesin e tij të krijimit, në dallim më krejt poezinë shqipe të fundviteve 1960 dhe fillimit të viteve 1970, kur Rreshpja hyri me autoritet, i vëzhguar edhe nga kritika e kohës, kryesisht për harmoninë për abstragimin e fjalës dhe kontekstet e figurës. “*Në rrugën e përgjithësimeve në përpunimin e një poezie meditative, kanë ecur gjithë poetët tanë më të mirë, veçanërisht me vëllimet e fundit “Motive me diell”, “Mesditë”, “Ritme të hekurta”, “Rapsodi shqiptare”, e “Zëri im”. Këta kanë krijuar në poezinë e tyre, marrëdhënie harmonike midis abstragimit dhe ndjenjës, fjalës, figurës.*”⁸

⁷ M. Zeqo, *In memoriam për Frederik Rreshpjen*, “Koha Jonë”, 18 shkurt 2006, f. 14-15.

⁸ B. Kuçuku, *Poezia akuale*, “Drita”, 20 gusht 1972, f. 4.

Rrjeti i sistemit të metaforave emërore shprehje e një prirjeje individuale...

Rreshpja e organizon poezinë e tij të bazuar në grupe gjithëçfarë metaforash emërore, si rastin kur si bërthamë shërben kryefjala, e pasuar nga grup emëror, ashtu edhe në rastin kur si bërthamë shërben kallëzuesi dhe pasohet nga grup emëror, madje, shpeshherë edhe nga disa grupe emërore, njëri pas tjetrit. Le të ndalemi dhe ta shikojmë këtë cilësi të tij në poezinë “Ajkuna”⁹.

AJKUNA

Kështu gjithnjë
Je dukë pas luftrave, anës shesheve të betejave,
Mes tymit të armëve të moçme, nën kështjellat
pellazgjike;
me ruben e zezë mbi sy, ti vije
në heshtjen e mbasluftës, mbramjeve

Dhe thurje ngadalë nën mjegullën e hollë që
endnin yjtë

Elegjitë epike:

Elegjitë epike me konstrukt të fortë,
Si shpellat e viseve shqiptare.
Kështu u ngrite ti mbi karvanin e thinjun
të bardëve,
Mbi kohnat e errëta plot klithma
Me kanget e tua prej nane.

Po ta vërejmë me kujdes, pikë së pari, mund të konstatohet se, në këtë poezi, foljet janë të pakta (*je dukë, vije, thurje, endnin, u ngrite*) ndiqen nga disa grupe metaforash emërore, ndërsa foljet sikur qerthullojnë a thurnojnë në mes strukturat emërore, duke krijuar një imazh të një skene mistike të daljes së Ajkunës “me rubën e zezë” menjëherë pas betejave, gjë që na kujton rënien e Omerit në bjeshkë dhe vajtimin e famshëm për të.

⁹ F. Rreshpja, *Rapsodi shqiptare*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1968, f. 38.

Grup emëror (GE) + folje +grupe emëror (GE)

Folje +grup foljor (GE)

Je dukë

- pas lufrave (emër i rasës rrjedhore me parafjalë)
- anës shesheve të betejave (grup emëror, i përbërë nga rrjedhore me parafjalë + emër në gjinore);
- Mes tymit të armëve të moçme (grup emëror, i përbërë nga emër i rasës rrjedhore me parafjalë + emër në gjinore, që ndiqet nga një mbiemër cilësor);
- nën kështjellat pellazgjike (grup emëror, me emër në kallzore, me parafjalë + mbiemër cilësor).
- me rubën e zezë mbi sy (grup emëror, me emër në kallzore + mbiemër cilësor + një emër tjetër po në kallzore me parafjalë).
- kështu (ndajfolje)
- gjithnjë (ndajfolje)

Rrjeti i sistemit të metaforave emërore shpreh një prirje individuale të Rreshpjes, një koncept aspektiv që ka për qëllim të përcjellë tek lexuesi qenien tij poetike, gjendjen emocionale bazuar tek portreti i Ajkunës, i konceptuar si strukturë mitologjike e këngës epike, legjendare. Këtë ka pasur parasysh edhe kritiku Moikom Zeqo, i cili, pikërisht për të vënë në dukje këtë veçori origjinale të stilit dhe vetjakësisë së Rreshpjes, si poet i vetvetishëm dhe original, ka shkruar:

“Frederik Rreshpja pikturon si një Van Gog. Për të krijuar një fakt një kozmogoni ngjyrash dhe ndijimesh, ku pantezimi është edhe impresionizëm, ku ka përherë shumë fanitje fosforeshente, fantazma të shenjta të kujtesës kombëtare, kalorës anonimë, të imagjinatës,

Rrjeti i sistemit të metaforave emërore shprehje e një prirjeje individuale...

detarë të qiellit, imazhe arketipalë të pashpërbëshëm ose metafora të antropomorfizuara.”¹⁰

Ndonëse me një sistem sintaksor në dukje të ngatërruar, që në një poezi nuk ka (dhe nuk mund të ketë) asnjëherë rregulla të ngurta, vëmë re elementin e lidhjes në distancë kuptimore të fjalëve, të cilat duken të vendosura mirë nga pikëpamja poetike.

U ngrite: mbi karvanin e thinjun të bardëve/ Mbi kohnat e errëta plot klithma/ Me kangët e tua prej nane.

Këtu folja pasohet me grupe emërore metaforash dyfishe si: “mbi karvanin e thinjun të bardëve”, “Mbi kohnat e errëta plot klithma”, “Me kangët e tua prej nane.”

Në këtë rast grupet emërore të metaforave janë shprehur:

- mbi karvanin (emër në rasën kallëzore, me parafjalë+ mbiemrin cilësor
- e thinjun + emër në gjinore: të bardëve)
- Mbi kohnat (emër në rasën kallëzore, me parafjalë + e errëta (mbiemër), që ndiqet nga një togfjalësh:
- Plot klithma (emër me parafjalë)
- Me kangët (emër me parafjalë)
- e tua (përemër pronor)
- prej nane (emër në rasën rrjedhore, me parafjalë)


Mistika e vajit të Ajkunës, një refleks si së shkuarës sonë zi, vjen si një marrëveshje në modernitetin tonë, jo vetëm si një kujtim “i kohnave pellazgjike, me erë të errët e plot klithma, por edhe si një dhimbje e përhershme nëne. Përfytyrimi apo imazhi i Vajit të Ajkunës nën hënën që ndriçon zbehtë Lugjet e Verdha, në vetmi diku përmes degëve të ahit, sjellin në poezinë e Rreshpjes një dhimbje të tejkohshme. Kjo gjendje duket edhe në strofën në vijim të poezisë.

II

ti vije

¹⁰ M. Zeqo, *In memoriam për Frederik Rreshpjen*, “Koha Jonë”, 18 shkurt 2006, f. 15.



në heshtjen e mbasluftës, mbramjeve



III

Dhe thurje ngadalë nën mjegullën e hollë që
endnin yjtë

Elegjitë epike:



III

Folje +grup foljor (GE)

U ngrite:

- mbi karvanin e thinjun të bardëve(grup emëror në rasën kallëzore).
- Mbi kohnat e errëta plot klithma (grup emëror, me emër me parafjalë në rasën kallëzore me parafjalë + mbiemër).
- Me kangët e tua prej nane (grup emëror, me emër në rasën kallëzore + përemër pronor + emër në rasën rrjedhore).

“Ajkuna” është një poezi me format të veçantë, ku vetë forma është kuptim dhe domethënie. Vetë titulli i poemës: “Ajkuna”, është një metaforë emërore (si antroponim), por edhe si metaforë e gruas në përgjithësi. Janë disa emra të shqipes, si Lokja që vjen nga zbunimi i nanës (**nanlokes**), që japin edhe ngjyrën e kohës, po edhe të vendit. Kështu edhe Ajkuna, nga eposi i Kreshnikëve, ka kaluar tashmë në simbolin e nënës së pikëlluar, të nënës që vajton të birin, që blasfemon e nam qiellin e Hënën, pse nuk e kanë njoftuar me kohë të dalë në bjeshkë dhe, në mos tjetër, të varrosje në një varr me të birin. Ajkuna e Rreshpjes, pra, është një **metaforë-krua**, një metaforë prej së cilës rrjedhin edhe një varg metaforash të tjera, që të gjitha të vetvetishme e prekëse, po edhe origjinale.

Autori synon që brenda një strukture të shkujdesur simbolesh, metaforash dhe imazhesh, të shpërndara nëpër poezi, të krijojë një unitet dhe lidhje mes pjesëve të poezisë. Pasi vetë letërsia në fund të fundit është metaforike dhe simbolike. Përkthyesi i njohur Hans-Joachim Lanksch, dy vjet para vdekjes së poetit, do të shprehej: *“Reshpja s’është poet i gazëllimit himnik, pa lëre ekzaltimin kombëtar. Temat e tij janë humbja, dhimbja, vetmia, qi i derdh në vargje të një individualiteti dhe bukurie prekëse. Larg gjithë toposëve avazesh albanocentrike, poezia e Frederik Reshpes është letërsi e dorës së parë të kalibrit europian.”*¹¹

Është e qartë se Rreshpja ishte një poet i formatit të madh. Nuk e di nëse në atë kohë kur ka botuar “Rapsodi shqiptare” të ketë pasur mundësi ta njohë Ungarentin¹² dhe stilin të mbyllur hermetik, por misticizmi i tij e afron me atë shkollë me shumë gjurmë në poezinë europiane. Ky fenomen i interferimit në poezinë shqipe të kohës i kësaj rryme siç quhej nga kritika zyrtare “dekadente”, nuk shkoi pa u vënë re nga kritika e kohës. Në vend që, sidoqoftë, të kishe pasur cilësimin se po sillte elemente të veçanta të stilit e të ndërthurjes origjinale të vargjeve, Frederik Rreshpjes, përkundrazi, i qe dhënë

¹¹ Publikuar në “albanovaonline.com”, më 2 qershor 2004.

¹² G. Ungaretti (1888 - 1970) ishte një poet modernist italian, gazetar, eseist, kritik, akademik. Një përfaqësues kryesor i "hermetizmit". Ai ishte një nga kontribuuesit më të shquar të letërsisë italiane të shekullit të 20-të.

një flakaresh i ashpër që mbetet, pa dyshim, si një nga shenjat e zeza të ideologjisë së asaj kohe, kur për të që shkruar:

*“Shfaqje të huaja dhe influencë, veçanërisht të karakterit hermetik e të fryrjes së vargut me një figuracion nganjëherë alogjik ka edhe në një varg poetësh të talentuar ...”*¹³

Në një editorial të gazetës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, duke shprehur shqetësimin për ndikimin e hermetizmit në poezinë e kohës, artikullshkruesi, pasi analizon poezi të shkëputura të autorëve të ndryshëm, thekson: *“Ndonjëherë këto vargje bartin edhe shenja të një filozofie të huaj, të marrë ndofta pa e kuptuar. Disa nga ta si Xh. Spahiu, M. Zeqo, R. Marku, F. Haliti, Th. Dino e ndonjë tjetër kanë dhënë prova të një pune serioze poetike. Kjo s’do të thotë se vargje të errëta dhe me mbingarkesë figuracioni nuk kanë edhe poetët tjerë. Biles vargje të tillë do të gjeshë edhe tek poetët që kanë një eksperiencë më të madhe poetike si tek F. Arapi dhe F. Rreshpja.”*¹⁴

Ky stil e afron Rreshpjen me shumë edhe me Martin Camajn, sido që poeti tjetër i Dukagjinit ishte më hermetik dhe operoi me një leksik më të ngushtë dhe gjeografi më të lokalizuar.

Rreshpja e tejkaloi poezinë e viteve ’60, sido që shanset e tij për sukses u vunë qysh në fillim në dyshim për shkak të kufizimeve ideologjike të realizimit socialist.

Kritiku i njohur Razi Brahimi pas analizon poezinë *“Unë jam fik deti”*, botuar në revistën e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë *“Nëntori”* nr. 10, 1972, thotë: *“Pra problemi nuk është thjeshtësisht nëse është i qëlluar vargu metaforik “Unë jam fik deti” dhe nëse do t’u jepet kuptim i saktë shoqëror dhe logjik krahasimeve që përbëjnë vjershën e përmendur, por me vetë prirjen që ka lindur këtë vjershë, te një fenomen letrar i ditëve tona, që pretendon të jetë një nga shfaqjet kryesore të modernizmit të poezisë, të ngjeshjes së saj me mendimin nëpërmjet metaforave dhe simboleve, qoftë edhe duke u shkëputur nga realiteti shoqëror...”*¹⁵

¹³ Gazeta “Drita”, 11 mars 1972, f. 2.

¹⁴ Gazeta “Drita”, 20 gusht 1972, f. 4.

¹⁵ Gazeta “Drita”, 3 dhjetor 1972, f. 5.

Rrjeti i sistemit të metaforave emërore shprehje e një prirjeje individuale...

Dhe, në fund, edhe dy raste të tjera, ku folja si “thurimë” e vargut të gjatë të metaforave emërore, është një tipar i veçantë i stilit poetik të Frederik Rreshpjes tek vëllimi i tij i parë me poezi: “Rapsodi shqiptare”.

DE RADA¹⁶

Vetëm plaku **mbet** atje ndanë detit,
Ndanë zhurmave të klatra dhe rrokupujës
së valëve;

Ndanë kohnave plot tallaze dhe rromujë.
I bardhë dhe i bukur si një kangjele.
Shkëlqen ai nën fjalët: **Erdhi** dita e Arbërit

Struktura

Grup emëror + grup foljor

Grup emëror:

Vetë plaku:

- *I bardhë dhe i bukur.*
- *si një kangjele*

Grup foljor

Mbet:

- *atje*
- *ndanë detit*
- *Ndanë zhurmave të klatra dhe rrokupujës së valëve*
- *Ndanë kohnave plot tallaze dhe rromujë*

-Shkelqen ai nën fjalët: **Erdhi** dita e Arbërit

¹⁶ F. Rreshpja, *Rapsodi shqiptare*, f. 19.

Ja edhe në një poezi tjetër

ELEGJI KOSOVARE¹⁷

...lokja plakë...
...**hodhi** një grusht dhe
Një grusht nga hini i gjyshave të lashtë,
Stërpikë me gjakun dhe djersën e breznive,
Një copë të thermueme malesh, të njomun
Ndër mijëra muzgje,
Ndër mijëra agime,
Një copë të dhimbshme, Kosovë

Dhe **vajti** ajo e **qëndroi** te gardhi i vjetër,
E plakun, e krrusun
Nga dhimbja, vetmia dhe shiu.
Mes lotëve të ndritshëm **gremoseshin**
Konturet e zeza të reve.
Dhe kryqat e thyem të vetëtimave

¹⁷ F. Reshpja, *Rapsodi shqiptare*”, f. 20.